


Aktualitet

Nga automatikë, kundërajror, predha antitank e mijëra fishekë, arsenal i armëve të mbështjellë me flamurin e PD-së

Policia ka reaguar zyrtarisht në lidhje me arsenalin e armëve të sekuestruara ditën e sotme në ambientet në pronësi të Sokol Xhurës. Policia thotë se ka gjetur dhe sekuestruar në një ambient të përshtatur, një arsenal armësh luftarake të kalibrave të ndryshëm dhe municion luftarak: 50 automatik, 1 pushkë të precizionit të lartë (Snajper), 1 snajper draganoz, 1 antitank, 19 kundërajrorë, mitroloz (2 të rëndë dhe 1 të lehtë), pajisje ushtrarake, 10 dybli që përdoren për pushkët dhe snajperat, dhjetëra mijëra fishekë të kalibrave të ndryshëm, 24 predha antitank, 1 arkë me lëndë eksplozive tritol, 100 granata të ndryshme, 6 kilogramë lëndë eksploziv C4, 7 armë zjarri pistoletë të modeleve të ndryshme, 53 pushkë model 10 dhe pjesë për riparimin dhe modifikimin e armëve të zjarrit. Ajo që shihet është se arsenal i armëve është i mbështjellë me flamurin e PD-së.

“Gjatë operacionit të zhvilluar ditën e sotme u zbuluan dhe u goditën edhe 2 baza të tjera që shërbenin për modifikimin, magazinimin dhe shitjen e armëve luftarake nga grupe kriminale që kryenin krime kundër personit.



LEXO EDHE:
'Do të jetë qyteti i ëndrrave', Veliaj me Ballukun në Kombinat flasin për procesin e rindërtimit: Në lagjen e projektuar nga Marco Casamonti edhe një xhami e re

Strukturat për Hetimin e Krimeve të Rënda në Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, me mbështetjen e sektorit operacional dhe Forcës së Posaçme "Shqiponjat" në DVP Tiranë, nën drejtimin e SPAK-ut, në vijim të operacionit policor të koduar "Kompleks", kanë lokalizuar dhe goditur dhe 2 baza të tjera që shërbenin po për modifikimin, magazinimin dhe furnizimin me armë të grupeve kriminale në territorin e të gjithë vendit.

Në kuadër të operacionit të zhvilluar këtë mëngjes, gjatë kontrollit të maganizës së shtetasit Sokol Xhura, i cili është shpallur më herët në kërkim, Policia ka gjetur dhe sekuestruar në një ambient të përshtatur, një arsenal armësh luftarake të kalibrave të ndryshëm dhe municion luftarak: 50 automatik, 1 pushkë të precizionit të lartë (Snajper), 1 snajper draganoz, 1 antitank, 19 kundërajrorë, mitroloz (2 të rëndë dhe 1 të lehtë), pajisje ushtrarake, 10 dybli që përdoren për pushkët dhe snajperat, dhjetëra mijëra fishekë të kalibrave të ndryshëm, 24 predha antitank, 1 arkë me lëndë eksplozive tritol, 100 granata të ndryshme, 6 kilogramë lëndë eksploziv C4, 7 armë zjarri pistoletë të modeleve të ndryshme, 53 pushkë model 10 dhe pjesë për riparimin dhe modifikimin e armëve të zjarrit.

Më herët, më datë 01.04.2021, në kuadër të këtij operacioni u zbardhen tri ngjarje kriminale me armë e eksploziv të ndodhura më parë, u vunë në pranga 9 persona dhe u shpallën në kërkim 2 të tjerë, të përfshirë në këtë veprimtari kriminale.

Po në kuadër të operacionit të zhvilluar më datë 01.04.2021, Policia zbuloi 18 baza, gjeti dhe sekuestroi arsenal armësh luftarake të llojeve të ndryshme, snajper, antitanke, kallashnikovë, pistoleta, silenciatorë, radio policie e ushtrie, optikë termikë për snajper, pjesë të ndryshme për modifikimin e armëve luftarake e sasi municionesh luftarake, 7 automjete, 2 prej tyre të blinduara.

Policia e Tiranës është e vendosur për të krijuar një ambient sa më të sigurt duke parandaluar dhe goditur ashpër të gjithë personat që tentojnë të ushtrojnë veprimtari kriminale në fushën e krimeve kundër personit, në fushën e narkotikëve apo trafiqeve të paligjshme dhe në këtë kuadër fton qytetarët që të vijojnë bashkëpunimin e shkëlqyer me strukturat e Policisë së Shtetit, duke denoncuar çdo rast të paligjshmërisë në Komisariatin Dixhital dhe në numrin pa pagesë 112.- njofton policia.

Lajmi kryesor:
Pamje ekskluzive/ Zbulohet baza e19-të e vrasësve me pagesë, SPAK mësyn në depon e armatimit në banesën e Sokol Xhurës! Arsenal i armëve të mbështjellë me flamurin e PD-së

M.Q./B.K./Shqiptarja.com

TAG:

tirane

spak

arsenal armesh

operacioni kompleks

Enver Jamaku

Ermond jamaku

sokol xhura

Sondazhi i ditës:
Zgjedhjet e 25 Prillit/Mendoni se votimi dhe numërimi elektronik do të ishte më efikas për procesin dhe duhej të shtrihej në më shumë zona?

PO

JO

NUK E DI

Lajme të tjera

Aktualitet



Shokon vajza e abuzuar prej dy vitesh nga njerku: Ai më përdhunonte, kur nëna ikte në punë! Nëna: Nuk e dija, xhelozoja se e doja shumë

10 Prill, 22:41

Aktualitet



COVID-i i merr jetën mjekut psikiatër të spitalit të Krujës

10 Prill, 21:49


Aktualitet



Shqipëria arrin në kuotën e mbi 256 vaksinime në total! Sot morën dozën e parë 6134 persona

10 Prill, 21:10


Aktualitet



Ekskluzive/ Report Tv zbardh itinerarin e kontenerit ku u gjetën 143 kg kokainë, u nis nga Ekuadori në fillim të marsit! Ndërroi gjatë rrugës 4 anije

10 Prill, 20:07

Aktualitet



Droga në Portin e Durrësit/ Policia: Kapen rreth 143 kg kokainë, momenti i arrestimit të 2 administratorëve të kompanisë së bananeve

10 Prill, 19:47

Aktualitet



'Defender 21'/ Kim pret ushtarët amerikanë: Do trajnojnë Forcat e Armatosura Shqiptare për stërvitjen

10 Prill, 19:15